



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 34 datë 13.6.2022

**“PËR SHITESË NË BUXHETIN E VITIT 2022 E MIRATUAR ME “VKB NR. 3,
DATË 05.01.2022 "PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2022 DHE
PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PËRFUNDIMTAR 2022-2024 TË
BASHKISË SHKODËR”**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 13.6.2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 35 pika 1 shkronja “d”, nenit 54 shkronja “dh”, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar; ligjit 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”; nenit 20 pika 1 dhe 5 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat vendore”; Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; të ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetqeverisjes vendore”; të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 “Mbi procedurat standarte të zbatimit të buxhetit“, i ndryshuar; Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nr.1, datë 10.01.2022, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022“; VKM nr. 165, datë 02.03.2016 “Për grupimin e njërive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njërive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; Vendim nr. 234 dt. 20.04.2022 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike” Udhëzim nr. 830, datë 14.04.2008 “Për zbatimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale publike dhe jopublike”; VKM, Nr.107, Dt.15.02.2017, “Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr.114, datë 31.1.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës së kontributeve të personave që vendosen në institucionet rezidenciale publike, të shërbimeve të përkujdesit shoqëror”, të ndryshuar; Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe ACLI IPSIA (Instituti i

Pages, Inovacionit dhe Zhvillimit – ACLI) me nr. 4199 Prot., datë 21.03.2018, të shkresës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) nr 1134/19 prot datë 04.05.2022 “Njoftim” për përzgjedhjen fitues të projekt propozimit “Strehëz për fëmijët pa kujdes prindëror”, shkresës nr. 2084 prot. datë 11.05.2022, “Transferim fondesh për financimin e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashki për vitin 2022”, shkresës nr. 69/43 prot. datë 16.05.2022 “Akordim i fondeve për financimin e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në Bashki për vitin 2022.; VKB Nr. 3, Datë 05.01.2022 "Për miratimin e Buxhetit të vitit 2022 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2022-2024 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar, ndryshimeve të propozuara, si dhe pas shqyrtimit të relacionit të përgatitur nga administrata e Bashkisë,

V E N D O S I:

1. Të miratojë shtesën e planit buxhetor në shumën 7,841,995 Lekë në Buxhetin e vitit 2022 të Bashkisë Shkodër për projektin P10430.O5.A3 “Strehëz për fëmijët pa kujdes prindëror”, në programin 10430 “Kujdesi social për familjet dhe fëmijët”, të alokuara nga MSHMS për projektin e shpallur fitues “Strehëz për fëmijët pa kujdes prindëror”, në kuadër të thirrjes së Fondit Social 2022, sipas detajimit më poshtë:

Shpenzimet e llogaritura 2022					
Shpenzimet për çdo aktivitet		Totali	Nga kjo:		
		(Lek)	Paga	Sigurim e shoq + shënd	Shpenzim e Operative
A.1	Shpenzime për paga dhe sigurime të punonjësve	5,076,995	4,350,467	726,528	
A.2	Mjete Kancelarike	35,000			35,000
A.3	Materiale higjieno sanitare dhe dezinfektim	105,000			105,000
A.4	Uniforma dhe veshje të tjera speciale (veshje dhe rroba fëmijësh)	140,000			140,000
A.5	Ilaçe, materiale dhe shërbime mjekësore	56,000			56,000
A.6	Furnizime me ushqime	878,500			878,500
A.7	Elektricitet	294,000			294,000
A.8	Uji	175,000			175,000
A.9	Posta dhe Shërbimi Korrier	9,000			9,000
A.10	Gaz për kuzhinë	42,000			42,000
A.11	Internet/TV/Telefon	28,000			28,000
A.12	Karburant dhe vaj	210,000			210,000
A.13	Pjesë këmbimi, goma dhe bateri	56,000			56,000
A.14	Shpenzime të siguracionit/kolauditimit të mjetit të transportit	50,000			50,000
A.15	Shpenzime të tjera transporti	14,000			14,000

A.16	Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore	96,000			96,000
A.17	Shpenzime për sigurimin e ndërtesës dhe të tjera kosto sigurimi të ngjashme	35,000			35,000
A.18	Shpenzime për honorare, Bonus mujor për fëmijët sipas udhëzimit	56,000			56,000
A.19	Trajnime stafi	175,000			175,000
A.20	Materiale promocionale	87,500			87,500
A.21	Klasat e prindërimit / Terapi Familjare	63,000			63,000
A.22	Trajnime/kurse profesionale për nxitjen e punësimit dhe aftësimit	70,000			70,000
A.23	Trajnime i familjes kujdestare	84,000			84,000
A.24	Aktivitete ndërgjegjësuese	6,000			6,000
	Shuma 2022	7,841,995	4,350,467	726,528	2,765,000
	Shuma totale e Projektit e financuar nga MSHMS	7,841,995	4,350,467	726,528	2,765,000

2. Të miratojë ndryshimin e numrit të punonjësve të Bashkisë Shkodër në Tabelën nr. 2 "Numri i Punonjësve 2022", përbërëse e VKB Nr. 3, Datë 05.01.2022 "Për miratimin e Buxhetit të vitit 2022 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2022-2024 të Bashkisë Shkodër" sipas detajimit më poshtë:

	Numri i punonjësve të miratuar	Numri i punonjësve me kontratë
Bashkia Shkodër	422	31
Drejtoria e Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore	34	18
Dega Ekonomike e Kulturës	31	
Teatri "Migjeni"	42	
Drejtoria Ekonomike e Arsimit	229	
Drejtoria e Çerdheve dhe Kopshteve	240	
Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit	42	
TOTALI	1,040	49

	Bëhet	Viti 2022
	Numri i punonjësve të miratuar	Numri i punonjësve me kontratë
Bashkia Shkodër	431	31
Drejtoria e Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore	34	18
Dega Ekonomike e Kulturës	31	
Teatri "Migjeni"	42	
Drejtoria Ekonomike e Arsimit	229	
Drejtoria e Çerdheve dhe Kopshteve	240	
Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit	42	
TOTALI	1,049	49

Niveli i pagave të punonjësve "Strehëz për fëmijët pa kujdes prindëror"

Emërtimi	Arsimi i lartë			Arsimi i mesëm	Vjetërsia
	Kategoria	Pozicioni	Klasa	Paga baze mujore	Shtesa për vjetërsi, në përqindje
Përgjegjës Sektori	III-a	50,000			2%
Specialist	IV-b	38,000			2%
Shofer			IV	34,100	1%
Kuzhinier			VI	35,000	1%
Sanitar			I	32,000	1%
Punonjës mirëmbajtje			IV	34,100	1%
Kujdestar			VIII	36,000	1%

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar.

KRYETAR



Brisela KADIJA

Sekretari i Këshillit Bashkiak



Denis Lesha

Miratuar me 26 vota

Vota Pro 26

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 15.6.2022